BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE *(BulletinonNaturalHazards)*
Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore
Facebook page: Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 330 / 2026, 26-11-2026	**Parashikimi** nga 26-11-2026, ora 12:00 deri 27-11-2026, ora 23:59.

PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

Sot (e enjte, dt. 26) dhe nesër (e premte, dt. 27) shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve në qarqet Shkodër, Kukës, Vlorë dhe Gjirokastër mund të krijojnë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastër mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve.
Këto reshje do të sjellin rritje të prurjeve në lumenjtë e mëdhenj dhe të mesëm Drin-Buna, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë.

PARASHIKIMI METEO

RESHJET

Sot pasdite (e enjte, dt. 26) dhe nesër (e premte, dt. 27) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Dibër, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastër. Në qarqet Shkodër, Kukës dhe Korçë priten reshje intensive, ndërsa në qarqet e tjera priten reshje mesatare deri lokalisht intensive. Në të gjithë qarqet priten shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark.

TEMPERATURA

Nesër (e premte, dt. 27) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 13 / 17 °C
në vendet e ulëta: 11 / 17 °C
në vendet malore: 7 / 13 °C

ERA

Sot pasdite (e enjte, dt. 26) era pritet të fryjë mesatare, ndërsa në bregdet e fortë deri shumë e fortë. Nesër (e premte, dt. 27) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

NIVELET E RREZIKUT	**S'KA RREZIK**	**I ULËT**		**I LARTË**

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	*Zjarre në pyje*	*Ngjarje Meteorologjike*			*Ngjarje Hidrologjike*		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	*Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*	*Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*	*Shtrëngata*	*Përmbytje të Shpejta*	*Përmbytje Lumenjsh*	*Rrëshqitje toke*
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive					
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive					
DIBËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
TIRANË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare	shumë intensive				
FIER	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KORÇË	S'KA RREZIK	intensive					
VLORË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				

LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

Niveli i Rrezikut	***Reshje shiu*** (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
I ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

SIMBOLE

	Shtrëngata: reshje mbi 20mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke



RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 26 – 27.